



КИНОТЕКА НА РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
KINOTEKA E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT
CINEMATHEQUE OF REPUBLIC OF NORTH MACEDONIA

www.kinoteka.mk

MEMBER OF FIAF

Ул. Никола Русински бр.1 п.фах 16, 1000 Скопје, Република Северна Македонија
тел: +389 2/ 3071-814, 3071-815, факс: + 389 2/ 3071-813

Rr. Nikolla Rusinski nr. 1 p.faks 16, 1000 Shkup, Republika e Maqedonisë së Veriut
Tel: +389 2/ 3071-814, 3071-815, faks: +389 2/ 3071-813

Nikola Rusinski 1 P.O.box 16, 1000 Skopje, Republic of North Macedonia
tel: +389 2/ 3071-814, 3071-815, fax: + 389 2/ 3071-813

bp. 04-686/1
30.9.2024

Në bazë të nenit 4 paragrafi 1 të Marrëveshjes për bashkëpunim afarist dhe teknik, të lidhur ndërmjet Institucionit Nacional Kinoteka e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Universitetit Ndërkombëtar Europa Prima, nr. 03-612/1, më 02.09.2024, sipas të cilit Universiteti ofron bursë të plotë për tarifat e shkollimit për një punonjës nga I.N. Kinoteka e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe në përputhje me Rregulloren për kriteret për pjesëmarrje në konkurs për fitimin e të drejtës në specializim, arsimim dhe zhvillim të mëtejshëm profesional, nr. 01-617/1, nga data 03.09.2024, publikohet

SHPALLJE INTERNE nr. 01/2024

PËR PËRZGJEDHJEN E KANDIDATËVE PER SPECIALIZIM, ARSIMIM DHE ZHVILLIM TË MËTEJSHËM PROFESIONAL

Institucioni Nacional Kinoteka e Republikës së Maqedonisë së Veriut publikon shpallje interne për 1 (një) person-kandidat për specializim, arsimim dhe zhvillim profesional për studime universitare në Universitetin Ndërkombëtar Europa Prima për vitin akademik 2024/2025.

Kriteret që duhet të plotësojë kandidati për të aplikuar në shpallje janë:

- të jetë ofrues i shërbimeve me arsim të mesëm të përfunduar
- të jetë në punë me orar të plotë në Kinotekë së paku 5 vjet
- Të kryejë punë në veprimtarinë që kërkon zhvillim dhe specializim të përhershëm profesional/shkencor, duke monitoruar proceset aktuale në fushën përkatëse për të përvetësuar njohuri të veçanta dhe të thelluara profesionale të cilat janë të nevojshme për kryerjen më të suksesshme dhe më cilësore të detyrave të punës.

Kandidatët e interesuar aplikojnë në shpalljen interne duke plotësuar një aplikim dhe duke paraqitur dëshmi për plotësimin e kriterëve.

Kandidatët aplikimit duhet t'i bashkëngjisin:

- Dëshminë e arsimit të përfunduar
- Dëshminë për përvojën e punës

Shpallja publike zgjat 8 ditë nga dita e publikimit në tabelën e shpalljeve.

Aplikimin me dokumentet e plota, kandidatët mund ta dorëzojnë direkt në arkivin e Kinotekës deri në orën 15:00 të ditës së fundit, në zarf të mbyllur me shënimin "Për shpallje interne për specializim, arsimim dhe zhvillim të mëtejshëm profesional, nr. 01/2024" në adresën I.N. Kinoteka e Republikës së Maqedonisë së Veriut, rr. Nikolla Rusinski, nr. 1, Shkup.

Përzgjedhja e kandidatëve të regjistruar do të bëhet nga Komisioni kompetent i formuar për zbatimin e procedurës për specializim, arsimim dhe zhvillim të mëtejshëm profesional. Aplikimi i vonuar, i pakompletuar dhe jo i plotë nuk do të shqyrtohet nga Komisioni.



u.d. drejtori
Boshko Grujoski

**FORMULARI I APLIKIMIT PËR SHPALLJE INTERNE PËR PËRZGJEDHJEN E KANDIDATËVE PËR
SPECIALIZIM, ZHVILLIM DHE ARSIMIM TË MËTEJSHËM PROFESIONAL**

1. Informacion në lidhje me shpalljen:

- Numri i shpalljes interne

2. Të dhënat personale për kandidatin:

- Emri

- Mbiemri

- I punësuar në sektorin (pozita aktuale, vendi, niveli)

- Kontakt telefoni

3. Të dhëna për plotësimin e kushteve të veçanta:

- Shkalla e arsimit ose kreditet e fituara sipas ECTS: IV, VI,
VII/1; VA 60-120, VIA 240, VIB 180 ECTS

Lloji i arsimimit

- Arsimi dhe institucioni

- Drejtimi

- Të dhëna për përvojën e punës - vite, muaj
